



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:230702

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442472

C.nr.149/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas ligjit Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, kundër të paditurës M.L nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Pasurim i pabazë, me vlerë të kontestit 360.00 euro, jashtë seance më datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C. nr. 149/18, për kthimin e mjeteve në shumën prej 360.00 euro, e paraqitur me datës 10.04.2018 nga paditësja Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas ligjit Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës për shkak të mosdorëzimit të provave në ekzemplar të mjaftueshëm për palën e paditur.

A r s y e t i m

Paditësja Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas ligjit Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, me datë 10.04.2018, ka paraqitur padi për kthimin e mjeteve në shumën prej 360.00 euro, kundër të paditurës M.L nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë.

Gjykata me aktvendimin e datës 20.02.2024, e ka ftuar paditësen që në afat prej 3 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi, gjykatës t'ia dorëzojë edhe një ekzemplar të provave për palën e

paditur, me paralajmërimin se gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta hedh poshtë padinë, në kuptim të dispozitës së nenit 102.3 dhe 102.4 të LPK-së.

Paditësja me datë 27.02.2024, e ka pranuar aktvendimin e datës 20.02.2024, por gjykatës nuk ia ka dorëzuar provat për palën e paditur.

Marr parasysh faktin se paditësja nuk ka vepruar sipas thirrjes së gjykatës për dorëzimin e provave, gjykata bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 102 par.3 dhe 102 par.4, lidhur me nenin 391 pika (g) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr. 149/18, me datë 12.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.